



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:245878
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05781860

C-IV-14-2595

Parashtruesi i kërkesës

M H nga Gjilani, përfaqësuar nga avokat **Sh Xh.**, Gjilan

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH – IDGJ “Industria e Duhanit” në likuidim),
Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 5 qershor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovohet si e bazuar.**
- 2. Shfuqizohet Aktvendimi i autoritetit të likuidimit GJI003-0790 datë 7 gusht 2013.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, M H që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, ti paguhet shuma prej 1,040.00 Euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % t'i paguhet shuma prej 104.00 Euro.**
- 4. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 prill 2014, pranë DHPGJS, ankuesi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, parashtroj një kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin në vijim: AL) GJI003-0790 datë 7 gusht 2013 (në tekstin në vijim: Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 1,040.00 (një zero katër zero) Euro, ndaj NSH IDGJ “Industria e Duhanit” (në likuidim).

Ankuesi pohoj se ishte punëtor i NSH dhe se nuk i janë paguar të ardhurat personale.

Duke vepruar sipas Njoftimit të Agjencisë, datë 15 gusht 2006, ashtu siç edhe është udhëzuar me njoftim, ankuesi pohon se i është drejtuar AL mbi kompensimin e pagave, në afatet e përcaktuara ligjore dhe se ky afat nuk është kontestuar as nga ana e AL.

Edhe përkundër kësaj, AL me Vendimin e saj, ka refuzuar kërkesën e ankuesit duke ju referuar parashkrimin, sipas dispozitave të Ligjit mbi punën e bashkuar – LPB, nenit 608.

Ankuesi kundërshtoj Vendimit e AL lidhur me parashkrimin, sepse sipas tij, i është përmbajtur afateve sipas Njoftimit dhe se, duke ju referuar Vendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan (tani gjykata themelore) thekson se pranë kësaj gjykata ishte duke u zhvilluar procedura gjyqësore, e disa punëtorëve, ndaj NSH por e njëjta ishte ndërprerë për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NSH.

Nga gjitha arsyet ankuesi pohon se pretendimet e AL mbi parashkrimin janë të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP (Shtojca e ligjit).

Ankuesi përfundimisht kërkon që kërkesa e tij mbi pagat e papaguara, për periudhën e kërkuar, të aprovohet duke përfshirë edhe kërkesën mbi kamatë ligjore duke filluar nga data 21 shtator 2007 kur edhe është parashtruar kërkesa kreditore pranë AL.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit të noterizuar, për përfaqësuesin e ankuesit,
- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e regjistrimit të punëtorëve të NSH, mbi pagat e papaguara për muajin gusht të vitit 2003 gjer me 20 maj 2004, në të cilën listë figuron emri i ankuesit sipas numrit rendor 35,
- Kopja e Njoftimit të Agjencisë, datë 15 gusht 2006, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës (në tekstin në vijim NJOFTIMI), dhe
- Kopja e Aktvendimit të Gjykatës komunale në Gjilan (tani gjykata themelore) C.nr.165/07 datë 21 maj 2008.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 11 mars 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankuesit konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP respektivisht Ligjit për punën e bashkuar - LPB, pasi që sipas AKP, ankuesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim ligjor në afat prej tre (3) vitesh për realizimin e kërkesës së tij. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankuesit të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur

- Vendimi i AL.

Përgjigja e AKP, me anë të urdhrin të gjykatës, ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 14 mars 2024.

Nuk është parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim konsiderohet e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

NJOFTIMI i parashtruar nga ankuesi, argumenton faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, respektivisht 15 gusht 2006, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë.

Në anën tjetër, AKP asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohet e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, me përgjigjen e saj, si të vetmen arsye mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Po nga NJOFTIMI i cili i është dorëzuar ankuesit nga AKP, shihet se marrëdhënia e punës së ankuesit i është ndërprerë me veprimin e AKP.

Gjykata gjithashtu gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi).

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompesim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP si dhe nenit 76 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212).

Gjykata rreth shumës së kërkuar për kompensim, vendosi në suaza të kërkesës së ankuesit (neni 2 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore).

Cështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesit

NJOFTIMI tregon faktin se ankuesi ishte i punësuar pranë NSH gjer me datën e privatizimit të saj.

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Së pari, duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi parashkrimin të aplikuara dhe referuar sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në nenin 370 thuhet, citat:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitë identike parashihet edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 351) dispozitë ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Sipas dispozitave të lartë cekura AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj ankuesit për obligime nga marrëdhënia e punës konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi.

Tutje, rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventuale, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHGPJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar